



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**



**Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit**  
**Regulativni Autoritet Telekomunikacije**  
**Telecommunications Regulatory Authority**

**Nr.Prot. 007/B/12**

**RREGULLORE**

**për**  
**Dhënien e Licencës për Radio Stacionet e Mjetit Ajror**

Kjo Rregullore është nxjerr në mbështetje të paragrafit (2) dhe (4) të nenit 4, të Ligjit për Telekomunikacion nr. 2002/7, të amendamentuar me ligjin nr. 03/L-085, Radio Rregulloret, Rekomandimet e ITU-së, Konventën e Aviacionit Civil Ndërkombëtare dhe Ligjin Nr. 03/L-051 Për Aviacionin Civil.

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Qëllimi i Rregullores është që përmes rregullave të përcaktuara në këtë Rregullore të sigurohet ofrimi i shërbimit të radio stacioneve të mjetit ajror/avionit mbi bazën e një licence të harmonizuar me rregullat dhe standardet ndërkombëtare të rekomanduara nga ITU (Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve) dhe me Konventën e Aviacionit Civil Ndërkombëtar.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

Objekti i Rregullores është publikimi i kriterëve dhe procedurës që zbaton Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit (ART) për dhënien e licencës për radio stacionet e mjetit ajror të regjistruara në Republikën e Kosovës, përdorimin e pajisjeve të tilla duke përfshirë përdorimin e frekuencave dhe përcaktimi i kërkesave teknike për caktimin dhe regjistrimin e shenjës së thirrjes.

**Neni 3**  
**Definicionet**

Definicionet, termet në vijim, do të kenë kuptimin e cekur në vijim:

**'Mjeti ajror'** - nënkupton çdo mjet apo pajisje, si aeroplan, helikopter, aeroplan pa pilot etj, që përdoren ose pretendohet të përdoren për fluturim në ajër dhe që përfitojnë mbështetjen nga atmosfera si pasojë e reaksioneve të ajrit, përveç reaksioneve të ajrit të cilat refuzohen nga sipërfaqja e tokës.

**‘Mjeti ajror kosovar’** - nënkupton çdo mjet ajror/avion te regjistruar në Kosovë në regjistrin e mbajtur nga Autoriteti i Aviacionit Civil në bazë të Ligjit Nr. 03/L-051, ‘Per Aviacionin Civil’.

**‘Radio stacion i mjetit ajror’** - nënkupton të gjitha pajisjet që përdoren në bordin e avionëve kosovar, me qëllim të realizimit të shërbimit radiokomunikues.

**‘Shenja thirrëse’** - nënkupton ndonjë kombinim të karaktereve ose shkronjave, e cila shenje identifikon një pajisje të komunikimit, një komandë, një autoritet, një aktivitet, ose një njësi, e përdorur kryesisht për krijimin dhe mirëmbajtjen e komunikimit.

#### **Neni 4 Aplikimi për licencë**

- 4.1 Mjetet ajrore, të regjistruara në Republikën e Kosovës, të cilat kanë të instaluara në bord pajisje radio-komunikimi duhet të pajisen me licencë për përdorimin e radio stacionit.
- 4.2 I Licencuari duhet të jetë pronari i regjistruar i aeroplanit dhe mund të jetë person juridik apo person fizik.
- 4.3 Personi që kërkon të pajiset me licencë për përdorimin e radio stacioneve të mjetit ajror duhet të paraqesë kërkesën sipas formularit të aplikimit të përcaktuar në Aneksin 1 të kësaj Rregulloreje, i cili shoqërohet me tabelën mbi të dhënat teknike dhe deklaratën e pronarit/personit të autorizuar.
- 4.4 Personi i cili bën një kërkesë sipas paragrafit 4.3 të kësaj Rregulloreje duhet t'i ofron ART informatat të cilat mund ti kërkojë, dhe në qoftë se personi, pa shkak të arsyeshem, nuk vepron në përputhje me këtë paragraf, ART mund të refuzoj dhënien e licencës për të.
- 4.5 Formulari i plotësuar ne origjinal dorëzohet në rrugë postare ose dorazi në ART.

#### **Neni 5 Dhënia e Licencës**

- 5.1 Licenca i lëshohet të interesuarit brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së Formularit të aplikimit të plotësuar në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në këtë Rregullore dhe pasi të ketë kryer të gjitha pagesat përkatëse për marrjen e licencës.
- 5.2 Kur ART-ja konstaton parregullsi në plotësimin e Formularit të aplikimit, i kërkon aplikuesit rregullimin e tyre brenda një periudhe prej 10 ditësh pas marrjes së njoftimit për parregullsitë e konstatuara.

#### **Neni 6 Detyrimet financiare**

- 6.1 Subjekti, me marrjen e njoftimit nga ART-ja për miratimin e licencës së kërkuar, është i detyruar që të paguajë tarifën e përcaktuar nga ART-ja:

6.1.1 Për radio stacionet ne mjetet ajrore me afësi ngritëse të peshës:

- i) ≤ 3200 kg: 30.00 €
- ii) > 3200 dhe < 14000 kg: 150.00 €
- iii) ≥ 14000 300.00 €

6.2 Mënyra, niveli dhe afati i pagesave si në paragrafin 6.1 të këtij neni, vendoset nga ART.

### **Neni 7 Vlefshmëria e licencës dhe rinovimi**

- 7.1 Licenca e lëshuar nga ART-ja sipas kësaj Rregulloreje është e vlefshme për një periudhë 1 (një) vjeçare nga data e hyrjes në fuqi të saj.
- 7.2 Për rinovimin e licencës, subjekti i drejtohet ART-së me kërkesë me shkrim 1 (një) muaj para përfundimit të vlefshmërisë së saj, duke paraqitur edhe ndryshimet, nëse ka të tilla.

### **Neni 8 Modifikimi/ndryshimi i licencës**

- 8.1 Modifikimi i licencës bëhet me kërkesën e subjektit, pa u kufizuar në rastet kur;
  - a) ndryshon emri i mjetit ajror,
  - b) adresa e të licencuarit ka ndryshuar,
  - c) kërkohet të ndryshohen ose shtohen radio pajisjet, apo
  - d) kanë ndryshuar të dhënat e tjera të përcaktuara në licencë.
- 8.2 I licencuari është i detyruar të njoftojë me shkrim ART-në për të gjitha ndryshimet.

### **Neni 9 Anulimi, Revokimi dhe Skadimi i licencës**

- 9.1 Licenca duhet të revokohet, pa u kufizuar vetëm në këto raste, në qoftë se:
  - 9.1.1 I licencuari dështon ti përmbush kushtet e licencës;
  - 9.1.2 Aplikacioni për licencë zbulohet se përmban informata të pasakta apo te rrejshme që kanë karakter të rëndësishëm;
  - 9.1.3 Një aeroplan largohet nga Regjistri i Avionëve Civil Kosovar, sipas nenit 42 te Ligjit për Aviacioni Civil.
- 9.2 Licenca do të skadojë:

- 9.2.1 me përfundimin e periudhës kohore për të cilën është lëshuar, nëse nuk ripërtërihet, apo
- 9.2.2 nëse i licencuari pushon se ekzistuari dhe transferimi nuk është bërë.
- 9.3 Nuk ka asnjë të drejtë për reimbursim të tarifave të licencës në rast të revokimit.

## **Neni 10** **Shenja e thirrjes**

- 10.1 Mjeteve ajrore që janë të pajisura me radio pajisje i caktohet shenja e thirrjes në përputhje me rregulloret ndërkombëtare të ITU-së.
- 10.2 Shenja e nacionalitetit<sup>1</sup> për mjetet ajrore kosovare do të jetë shenja 'Z6' si miratuar me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 03/46, datë; 02/11/2011
- 10.3 Shenja e thirrjes përcaktohet për mjetet ajrore që licencohen për herë të parë nga ART-ja dhe është unike për çdo mjet ajror.
- 10.4 Shenja e thirrjes i mbetet mjetit ajror për aq kohë sa nuk ndryshohet pronari apo emri i mjetit ajror.
- 10.5 Shenja e thirrjes dorëzohet në ART kur mjeti ajror bëhet i papërdorshëm ose nuk zhvillon aktivitet të licencuar, për një periudhe 2 ose më shumë vjet.
- 10.6 Shenja e thirrjes nuk transferohet midis mjeteve ajrore.

## **Neni 11** **Formimi i shenjës së thirrjes**

- 11.1 Në zbatim të përcaktimit të pikës 19.58 të Radio-Rregullores -ITU, shenja e thirrjes së mjeteve ajrore do të përbëhet nga dy karaktere dhe tre shkronja.
- 11.2 Stacionet që përdorin radiotelefoni mund të identifikohen nga sa vijon:
- 11.2.1 shenja e thirrjes e përcaktuar sipas paragrafit të mësipërm, që mund të pasohet nga një fjalë që tregon pronarin ose tipin e mjetit ajror, ose;
- 11.2.2 një kombinim i karaktereve që i korrespondojnë shenjës së regjistrimit zyrtar që i është caktuar mjetit ajror, ose;
- 11.2.3 një fjalë që tregon kompaninë ajrore, të pasuar nga numri i identifikimit ajror.

## **Neni 12** **Regjistrimi**

---

<sup>1</sup> Shenja e nacionalitetit në këto rast nënkupton shenjen thirrëse ( call sign) që përcakton shenjen e identifikimit nacional sipas pikës 19.50 të Radio Rregullerës së ITU

ART-ja regjistron të licencuarit në një regjistër i cili publikohet në faqen e internetit dhe përmban këto të dhëna:

- a) të dhënat mbi licencën (numri, data, vlefshmëria, etj.);
- b) pronarin e mjetit ajror (SH.P.K. / SH.A. / person fizik);
- c) emrin e mjetit ajror;
- d) shenjën e regjistrimit;
- e) shenjën e thirrjes;

### **Neni 13** **Ç'regjistrimi**

13.1 Ç'regjistrimi bëhet për rastet kur:

- 13.1.1. Licenca skadon
- 13.1.2 Licenca revokohet
- 13.1.3 Mjeti ajror shitet në një shtet tjetër,
- 13.1.4 Mjeti ajror bëhet i papërdorshëm,
- 13.1.5 Mjeti ajror është jashtë shërbimit, për një kohë prej 2 ( dy) ose më shumë vjet.

13.2 Mbjtësi i Licencës ka detyrim të njoftojë ART-në për rastet e mësipërme.

### **Neni 14** **Informimi në ITU**

ART-ja, bazuar në dispozitën 20.16 të Radio-Rregullores-ITU, informon ITU-në mbi subjektet e regjistruara (licencuara) apo ç'regjistruara.

### **Neni 15** **Kërkesat teknike**

- 15.1 Pajisjet e radio stacionit të mjetit ajror duhet të jenë në përputhje me standardet dhe rekomandimet përkatëse të institucioneve ndërkombëtare (ITU dhe EASA), të njohura e pranuar nga ART-ja dhe të zbatueshme në Kosovë.
- 15.2 Frekuencat dhe kanalet e punës që do të përdoren nga radio stacionet e mjetit ajror do të jenë ato të përcaktuara nga ITU dhe të specifikuar në nenin 16 (frekuencat dhe kanalet e punës) të kësaj Rregullore.
- 15.3 Radio stacionet e mjetit ajror duhet të përmbushin normat teknike dhe të mos u krijojnë interferenca rrjeteve tjera.

### **Neni 16** **Frekuencat dhe kanalet e punës**

- 16.1 Frekuencat e cilit do brez të caktuar për shërbimin e lëvizshëm aeronautikë (R) dhe shërbimin e lëvizshëm aeronautikë me satelit (R) në Planin Kombëtar të Frekuencave rezervohen për komunikime lidhur me sigurinë dhe rregullsinë e fluturimeve

Faqe 4 nga 10

ndërmjet çdo mjeti ajror dhe atyre stacioneve aeronautike dhe stacioneve tokësore aeronautike që lidhen kryesisht me fluturimet përgjatë korridoreve kombëtare dhe ndërkombëtare ajrore civile.

- 16.2 Frekuencat e cilitdo brezi të caktuar për shërbimin e lëvizshëm aeronautikë (OR) dhe shërbimin e lëvizshëm aeronautikë me satelit (OR) në Planin Kombëtar të Frekuencave rezervohen për komunikimet ndërmjet çdo mjeti ajror me stacionet aeronautike dhe stacionet aeronautike tokësore të ndryshëm nga ata që lidhen kryesisht me fluturimet përgjatë korridoreve të fluturimeve kombëtare dhe ndërkombëtare civile.
- 16.3 Frekuencat e brezave të caktuar për shërbimin e lëvizshëm aeronautikë ndërmjet 2850 kHz dhe 22000 kHz caktohen në përputhje me dispozitat e Apendikseve 26 dhe 27 të Radio-Rregullores së ITU-së.
- 16.4 Nuk lejohet asnjë korrespondencë publike në brezat e frekuencave të caktuara ekskluzivisht për shërbimin e lëvizshëm aeronautikë dhe shërbimin e lëvizshëm aeronautikë me satelit.

#### **Neni 17**

#### **Kërkesa të lidhjes me Radio Stacionin Aeronautik**

- 17.1 Transmetimi i sinjaleve në rast fatkeqësie, avarie, informacione të ndryshme ose shërbime të telekomunikacioneve, realizohen përmes stacioneve aeronautike në tokë.
- 17.2 Rregullat e komunikimit janë të përcaktuara në Radio-Rregulloren e ITU-së dhe në Konventën e Aviacionit Civil Ndërkombëtar.

#### **Neni 18**

#### **Sanksionet**

- 18.1 Është i ndaluar përdorimi i radio stacioneve të mjetit ajror pa qenë i pajisur nga ART-ja me licencë, sipas kësaj Rregulloreje.
- 18.2 Për shkelje të Ligjit nr. 2002/7 për Telekomunikacionin të ndryshuar me Ligjin, Nr. 03/L-085, kushteve të licencës dhe kërkesave të Rregullores, nëse nuk përbëjnë vepër penale, ART-ja zbaton sanksionet e parashikuara me Ligjin e Telekomunikacionit, Nr. 2002/7, të amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-085 dhe aktet e tjera të zbatueshme.

#### **Neni 19**

#### **Dispozita të tjera**

- 19.1 Kjo Rregullore hyn në fuqi datën e nënshkrimit të saj.
- 19.2 Çdo ndryshim i mundshëm i Rregullores do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës si dhe vendimet dhe rekomandimet e ITU-së, të pranuar nga Republika e Kosovës.

**Neni 20**  
**Hyrja në fuqi dhe vlefshmëria**

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit të saj nga Bordi i ART-së dhe mbetet në fuqi deri sa të nxirret një rregullore tjetër.

**Klasa: 01/12**  
**Reg. Nr. 13**

**Prishtinë, 30/01/2012**

**Ekrem Hoxha**  
**Kryetari i Bordit të ART-së**

-----

## ANEKSI 1

# FORMULAR I APLIKIMIT PËR PAJISJEN ME LICENCË PËR RADIO STACIONET TË MJETIT AJROR

### 1. Të dhënat e subjektit:

1.1	Pronari i mjetit ajror	
1.2	Adresa postare	
1.3	Telefon/Faks/E-mail	
1.4	Personi i Kontaktit	
1.5	Data e regjistrimit në autoritetin përkatës	
1.6	Nr. i regjistrimit	

### 2. Të dhëna mbi mjetin ajror:

2.1	Shenja e nacionalitetit dhe regjistrimit të mjetit ajror		
2.2	Shenja e thirrjes ose shenjë tjetër identifikimi		
2.3	Tipi i mjetit ajror		
2.4	Aftësia e peshës ngritëse		
2.5	Certifikata e Regjistrimit, lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil	Numri:	Data:
2.6	Certifikata e Operatorit Ajror	Numri:	Data:
2.7	Certifikata e Kontrollit Teknik	Numri:	Data:
2.8	Certifikata e Zhurmave	Numri:	Data:

### 3. Të dhëna mbi radio pajisjet të mjetit ajror:

	Pajisjet	Tipi	Fuqia (W)	Klasa e transmetimit	Brezi frekuencor ose frekuencat e caktuara
<b>1</b>	Transmetuesit				
1.1					
1.2					
1.3					
<b>2</b>	Transmetuesit e mjeteve të shpëtimit				
2.1					
2.2					
2.3					
<b>3</b>	Pajisje të tjera				
3.1					
3.1					
3.3					
3.4					
3.5					
3.6					



**DEKLARATË E PRONARIT/PERSONIT TË AUTORIZUAR**

Nën përgjegjësinë time të plotë ligjore, deklaroj se të dhënat, dëshmitë dhe informacioni i paraqitur në formularin e aplikimit dhe çdo lidhje të tij janë të vërteta, të sakta dhe në përputhje me çdo kërkesë të parashikuara ligjërisht mbi përgjegjësinë e vet deklarimit.

Me marrjen e licencës deklaroj se do të zbatoj;

- 1) Ligjin nr. 2002/7 për Telekomunikacionin, të datës 08 maj 2003, Ligjin nr. 03/L-085
- 2) Kushtet e Licencës;
- 3) Kërkesat e Rregullores për Dhënien e Licencës për Radio Stacionet të Mjetit Ajror.

---

Nënshkrimi dhe vula

---

Emri dhe mbiemri

---

Titulli

**Shënim:** Në rast se formulari i aplikimit paraqitet i plotësuar nga një person i autorizuar, autorizimi për këtë person duhet të shoqërojë formularin e aplikimit.

## ANEKSI 2



### Republika e Kosovës Republika Kosovo - Republic of Kosovo

**Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit  
Regulativni Autoritet Telekomunikacije  
Telecommunications Regulatory Authority**



### LICENCË E STACIONIT TË MJETIT AJROR - DOZVOLA ZA RADIO-STANICU NA VAZDUHOPLOVU

AIRCRAFT STATION LICENSE - LICENCE DE STATION D'AÉRONEF - LICENCIA DE ESTACIÓN DE  
AERONAVE

Nr. \_\_\_\_\_ Periodua e vlefshmërisë: nga \_\_\_\_\_ deri \_\_\_\_\_  
Br. \_\_\_\_\_ Period važnosti: od \_\_\_\_\_ do \_\_\_\_\_  
No. \_\_\_\_\_ Period of validity: from \_\_\_\_\_ to \_\_\_\_\_

Në përputhje me Rregulloren Nr. 13, ART Nr. Prot. 007/B/12 për Dhënien e licencës për **radio stacionet** të mjetit ajror të miratuar nga Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit i Republikës së Kosovës dhe me Radio-Rregulloren që shoqëron Statutin dhe Konventën e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU), lëshohet kjo licencë për instalimin dhe përdorimin e radio pajisjeve të përshkruara më poshtë:

Na osnovu Pravilnika br. 13, RAT Nr. Prot. 007/B/12 o izdavanju dozvola za radio-stanicu na vazduhoplovu izdat od Regulativnog Autoriteta Telekomunikacija Republike Kosova a u vezi sa Pravilnikom o radio-komunikacijama pridodatim Statutu i Konvenciji Međunarodne unije za telekomunikacije, izdaje se dozvola za postavljanje i korišćenje dole opisane radio opreme.

In accordance with the Regulation No. 13, TRA Prot. Nr. 007/B/12 on Issue of Aircraft Radio Station License issued by the Telecommunications Regulatory Authority of the Republic of Kosovo and with the Radio Regulations which complement the Constitution and the Convention of the International Telecommunication Union now in force, this authorization is herewith issued for the installation and for the use of the radio equipment described below.

1	2	3	4
Shenja e nacionalitetit dhe regjistrimit të mjetit ajror Državna pripadnost i oznaka registracije vazduhoplova Nationality and Registration Mark of the Aircraft	Shenja e thirrjes ose shenjë tjetër identifikimi Pozivni znak ili drugi znak identifikacije Call Sign or other Identification	Tipi i mjetit ajror Tip vazduhoplova Type of Aircraft	Pronari i mjetit ajror Vlasnik vazduhoplova Owner of Aircraft

	Pajisja Uređaji Equipment	a	b	c	d
		Tipi Tip Type	Fuqia (W) Snaga (W) Power (W)	Klasa e transmetimit Vrsta emisije Class of Emission	Brezi frekuencor ose frekuencat e caktuara Frekvencijski opseg ili dodeljene frekvencije Frequency Bands or Assigned Frequencies
5	Transmetuesit/Predajnici/Transmitters				
6	Transmetuesit e mjeteve të shpëtimit (nëse ka) Predajnici na sredstvima za spašavanje (usl) Survival Craft Transmitters (when applicable)				
7	Pajisje të tjera Drugi uređaji Other Equipment				

Prishtinë, Kosovë

Vendi  
Mesto  
Place

Data  
Datum  
Date

Kryetari i Bordit

Ekrem Hoxha  
Nënshkrimi - Potpis - Signature